

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2017, PËR PROJEKTIN “PROGRAMI PËR RINOVIMIN E KONVIKTEVE NË KAMPUSIN UNIVERSITAR TË TIRANËS, SIPAS PARIMIT TË EFIÇENCËS ENERGJITIKE, FAZA III”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të efijencës energjitike, faza III.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është rehabilitimi i konvikteve të Universitetit të Tiranës, duke synuar kursime të ndjeshme të energjisë, kushte jetese të përshtatshme dhe kosto të arsyeshme akomodimi. Për këtë arsye, financimi që premtion kjo marrëveshje i bashkohet qëllimit të programit për aplikimin e masave të efijencës së energjisë në godinat e konvikteve.

Me ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjes si më sipër, synohet që, nëpërmjet financimit të projektit, të kontribuohet në zhvillimin ekonomik e social të Shqipërisë, konkretisht, duke krijuar kushte më të mira jetese dhe studimi për një numër të konsiderueshëm studentësh, duke ulur ndjeshëm kostot që duhet të paguajë Bashkia Tiranë dhe Rezidenca Studentore Universitare nr.1 për ngrohje/ftohje dhe energji elektrike, por, mbi të gjitha, duke krijuar një model ekonomik të caktuar, i cili mund të aplikohet në shumë projekte të tjera publike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN ANALITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji është i paplanifikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Programi synon rehabilitimin e konvikteve të Universitetit të Tiranës, në funksion të rritjes së efijencës së energjisë dhe të kushteve të përshtatshme të studentëve, sipas kërkesave minimale të performancës së energjisë. Në varësi të buxhetit në dispozicion, projekti do të përfshijë rehabilitimin e konvikteve nr.3, 14, 16, 17 dhe 18, sipas përcaktimeve në marrëveshjet financiare tashmë të dakordësuara me KfW, në lidhje me financimet në vlerat prej 4 500 000 eurosh (faza I) dhe 2 032 179.23 eurosh (faza II), si dhe, mundësisht, rehabilitimin e dy – katër godinave të tjera konviktesh.

Në çdo rast, përpara se të fillojnë punimet për rehabilitimin me kushtet e efijencës së energjisë, parashikohet të përcaktohet fillimisht performanca energjetike aktuale e konvikteve nëpërmjet kontrolleve të energjisë dhe auditimit energjetik të godinave, të dhëna të cilat do të detajohen më tej nga konsulenti me qëllim krahasimin e këtij indikator të performancës energjetike ($\text{kwh/m}^2\text{vit}$) para dhe pas rehabilitimit të godinave.

Financimi që premton kjo marrëveshje i bashkohet qëllimit të programit për aplikimin e masave të efijencës së energjisë në godinat e konvikteve me objektivat, si më poshtë vijon:

- Auditimi energjetik i ndërtesave për të identifikuar konsumin e energjisë dhe masat përkatëse që duhen për të reduktuar konsumin e energjisë. Raporti i auditimit do të vlerësojë konsumin energjetik të ndërtesës para dhe pas rinovimit, si dhe do të propozojë masat për kursimin e energjisë.
- Identifikimi i nevojave të rinovimit të ndërtesave në lidhje me gjendjen aktuale të tyre për të zgjatur ciklin e jetës së ndërtesave;
- Identifikimi i masave të ndryshme të efijencës së energjisë që mund të aplikohet, si dhe llogaritja e kursimit të energjisë në secilën prej godinave, me qëllim përcaktimin e kritereve dhe të masave të efijencës së energjisë me një kosto të lartë përfitimi. Kjo nënkupton vendosjen e një kostoje optimale për rinovimin e ndërtesës, në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara në ligjin nr.116/2016;
- Reduktimi i konsumit të përgjithshëm të energjisë së ndërtesave, duke synuar që treguesi i performancës së energjisë të jetë të paktën 75 kwh/m^2 në vit dhe të sigurojë përmirësimin e kushteve të jetesës së studentëve.
- Llogaritjen e reduktimit të karbonit si rezultat i masave dhe vendosjes në kushte të performancës së lartë (sipas synimit të mësipërm $75 \text{ kwh/m}^2\text{vit}$) dhe të standardeve të Bashkimit Evropian.

Përveç rehabilitimit energjetik të ndërtesave, programi do të mbulojë në mënyrë të konsiderueshme masat themelore të komfortit sipas kushteve të vendosura

nga ligji nr.116/2016, si, për shembull, rinovimi i instalimeve sanitare, rinovimi i pajisjeve elektrike, sistemi i ngrohjes, ftohjes, ventilimit, prodhimit të ujit të ngrohtë sanitar, masat e sigurisë, lavanderi me operim monedhash, dhoma të përbashkëta studimi etj., në mënyrë që të përmirësohet jetesa dhe mjedisi i të mësuarit për studentët.

Projekti do të zgjasë nga 18 deri në 24 muaj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është i bazuar në Kushtetutë, në përputhje me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe është miratuar, në parim, me vendimin nr.734, datë 12.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përfron me ndonjë akt ligjor të Bashkimit Evropian, por është në përputhje me ligjin nr.116/2016, “Për performancën e energjisë në ndërtesa”, dhe ligjin nr.124/2015, “Për efikasitetin e energjisë”, të cilat transpozojnë pjesërisht direktivën 2012/27/BE dhe direktivën 2010/31/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, mbi performancën energjetike të ndërtesave.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin Universitar të Tiranës sipas parimit të efikasitetit energjetike, faza III”.

Me anë të kësaj marrëveshjeje të dyja qeveritë bien dakord për akordimin e një granti nga qeveria gjermane, me vlerën deri në 2 927 765,96 euro, financim i cili do të vihet në dispozicion nëpërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW).

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Projekti do të zbatohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe administratën e Rezidencës Studentore Universitare nr.1, Tiranë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Granti i akorduar nga qeveria gjermane është në vlerën maksimale 2 927 765.96 euro dhe është planifikuar të fillojë disbursimin brenda vitit 2019. Detajet e disbursimit të fondeve grant do të përcaktohen më pas në marrëveshjen financiare që do të lidhet mes palëve.

Projekti, që do të financohet nëpërmjet grantit si më sipër, është parashikuar në programin buxhetor afatmesëm 2019-2021, dhe, më konkretisht, në programin “Mbështetje për energjinë” të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

KËSHILLI I MINISTRAVE